



**Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Kombet e Bashkuara  
Korniza e bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm 2021-2025**

## **Plani i përbashkët i punës për vitin 2023**

### **1. Konteksti i vendit<sup>1</sup>**

Plani i përbashkët i punës për vitin 2023 u zhvillua në një kontekst sfidues politik dhe ekonomik që mbingarkoi kapacitetet institucionale dhe kërcënoi seriozisht standardin e jetesës së njerëzve, veçanërisht grupeve më të rrezikuara.

Kriza globale e energjisë dhe rritja e çmimeve të ushqimit minuan rimëkëmbjen ekonomike deri në fund të viti 2021, e cila u intensifikua me zhvillimet në Ukrainë. Ndikimi është kryesisht indirekt, që rrjedh nga mbështetja e fortë në importet e energjisë dhe ushqimit dhe eksposzimi i fortë tregtar në tregjet e BE-së. Njerëzit, por edhe bizneset dhe veçanërisht NVM-të janë goditur fuqishëm nga inflacioni dhe kriza e energjisë që minoi tashmë konkurrencën e ulët të ekonomisë. Tregu i punës u rrit në vitin 2021, megjithatë papunësia e të rinjve mbetet një problem. Financimi i deficitit buxhetor dhe shpenzimeve sociale është gjithnjë e më i vështirë, duke pasur parasysh rezervat (baferët) e shtuar financiar dhe përkeqësimin e tregjeve të kapitalit. Kapitali njerëzor mbetet ndër sfidat kryesore në ekonomi, me rënie të qëndrueshme të popullsisë të konfirmuar nga Regjistrimi i viti 2021 për shkak të uljes së fertilitetit dhe largimit të madh jashtë vendit. Pavarësisht reformave të vazhdueshme në arsim, rezultatet e të mësuarit mbenet në nivel të ulët dhe jo në përputhje të mjaftueshme me aftësitë (e ardhshme) të tregut. Ndërkohë që numri i rasteve me Kovid-19 ka rënë, sistemi shëndetësor vijon të ketë vështirësi për shkak të mungesës së burimeve dhe stafit mjekësor. Reforma sociale dhe lufta kundër informalitetit ende nuk ka dhënë rezultate, ndërsa të drejtat e fëmijëve dhe veçanërisht ato me aftësi të kufizuara janë përmirësuar.

Fokusi në ndryshimet klimatike, mjedisin jetësor dhe burimet natyrore është zvogëluar me përkeqësimin e ndotjes së ajrit për shkak të krizës energetike. Fokusi mbizotëruesh në krizë, prokurimi publik i dështuar në investimet e mëdha mjedisore (p.sh. OTUZ Shkup, Hidrocentrali Çebren Shkup, transporti publik i gjelbër në Shkup) dhe mbështetja më e madhe në lëndët djegëse fosile për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë rezultuan në më pak progres në çështjet e mjedisit jetësor. Nga ana pozitive, çmimet e rritura të energjisë po nxisin stimujt për tranzicionin e gjelbër, duke i bërë investimet e energjisë së ripërtërishme më tërheqëse. Sa i përket gjendjes së tre liqeneve të mëdha, sfidat vazhdojnë, me situatën në Prespë dhe Ligenin e Dojranit që veçanërisht është shqetësuese dhe përkeqësuese. Investime të rëndësishme në menaxhimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta, menaxhimin e burimeve natyrore, si dhe fokus më të madh në riciklimin janë të nevojshme.

Propozimi i ashtuquajtur "francez", i pranuar nga Qeveria dhe Parlamenti, ndihmoi në tejkalimin e vetos bullgare në Kornizën e negociatave të BE-së me Maqedoninë e Veriut. Procesi i shqyrtimit të nivelit të transponimit të *acquis* të BE-së u nis në korrik të viti 2022, megjithatë negociatat me BE-në do të hapen zyrtarisht vetëm pasi vendi të përfshijë pakicën bullgare në preambullën e Kushtetutës. Ndërkohë, sfidat dhe vonesat brenda procesit të anëtarësimit në BE kanë ulur mbështetjen popullore për integrimin në BE dhe kanë thelluar polarizimin politik të shoqërisë. Përfshirja dhe pjesëmarria e palëve të interesuara dhe shoqërisë në përgjithësi në hartimin e politikave është përmirësuar, megjithatë kapaciteti i zbatimit, barazia dhe besimi i publikut në institucione vazhdoi të tkurrej. Korrupzioni dhe mungesa e llogaridhënieve mabetet problemi kryesor i shoqërisë. Qeveria vazhdoi të angazhohej me mekanizmat e OKB-së dhe Evropës për të drejtat e njeriut, megjithatë, integrimi dhe ndjekja e rekomandimeve të tyre mbetet sfiduese.

<sup>1</sup>Në bazë të [përditësimit të Analizës së përbashkët të vendit të OKB-së \(APV\) 2022](#)

Konsultimet për të formuluar një Strategji kombëtare për zhvillim për periudhë njëzetyjeçare vazduan dhe u nisën disa reforma të rëndësishme siç është reforma e re buxhetore, si dhe politikat që synojnë grupet e rrezikuara si gratë, të rinjtë, personat me aftesi të kufizuara dhe romët. Kriza shumëdimensionale përkeqësoi mjesin tashmë të vështirë operativ për pushtetet lokale. Lëvizjet e përziera migruese vazduan përtej kufijve për shkak të pozicionit gjeostrategjik të vendit në nën-rrugën e Ballkanit Perëndimor dhe vendi priti 22,000 refugjatë të ardhur nga Ukraina. Kanë mbetur vetëm 5,900 persona, të cilët kanë vështirësi në qasjen në arsim, punë dhe të ardhura. Pashtetësia ende nuk është adresuar. Ekziston një hapësirë për zhvillim digjital, pasi vendi është nën mesataren evropiane në një kornizë rregullatore më të gjërë.

Përfocimi i kapaciteteve të menaxhimit dhe zbatimit të të dhënave, rritja e luftës efektive kundër korruptionit dhe informaliteteve dhe hartimi i masave anti-krizë që synojnë fuqimisht nevojat e më të rrezikuarve në kontekstin e financimit të pakët do të jenë kritike për vendin në periudhën në vijim. Përkundër sfidave aktuale, vendi duhet gjithashtu të mbajë angazhimin për investime strategjike në kapitalin njerëzor, sigurinë ushqimore, ndryshimet klimatike, mjesin jetësor dhe rezistencën ndaj fatkeqësive.

## 2.Reth planit të përbashkët të punës

Planet e përbashkëta të punës (PPP) janë mjeti vjetor që operacionalizon Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Kornizën e bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara 2021-2025 (KBZHQ) – dokumenti kryesor strategjik që udhëzon punën e subjekteve të sistemit të zhvillimit të OKB-së në Maqedoninë e Veriut.

Të gjitha programet e vendeve të subjekteve të OKB-së rrjedhin nga KBZHQ dhe konsolidohen çdo vit në plane të përbashkëta të punës, një për rezultatin e KBZHQ (shih më poshtë).

### *Prioritetet strategjike dhe rezultatet e KBZHQ*

OZHQtë	Prioriteti strategjik	Rezultatet deri në vitin 2025
Prosperiteti dhe njerëzit	1. Zhvillim ekonomik dhe social i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës	1. Standardi jetësor i të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut përmirësohet përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësim produktiv të gjeneruar nga një ekosistem i biznesit gjithëpërfshirës dhe inovativ
		2. Njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbimet sociale cilësore të bazuara në të drejtë – kujdes shëndetësor, arsim dhe mbrojtje e nevojshme sociale dhe përfëmijët - të rrënjosura në sisteme rezistente ndaj emergjencave.
Planet për OZHQ	2. Veprimi klimatik, burimet natyrore dhe menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitet	3. Njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze klimatike, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes rregullimit të mirë të mjesitjet jetësor dhe komuniteteve rezistente ndaj fatkeqësive
OZHQtë e paqes	3. Qeverisje demokratike transparente dhe llogaridhënëse	4. Njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga përmirësimi i sundimit të ligjit; politika të bazuara në dëshmi, parashikuese dhe me përgjegjësi gjinore; kohezion më i madh social; dhe ofrim efektiv të shërbimeve nga institucione transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme


PPP-të të vitit 2023 konsolidojnë në këtë mënyrë aktivitetet që do të ndërmerren nga 17 subjekte të OKB-së gjatë vitit 2023. Katër rezultatet dhe 19 autputet zbatohen përmes 144 nënprodukteve (shuma e aktiviteteve që synojnë arritjen e një rezultati të caktuar) siç është planifikuar nga subjektet e OKB-së përmes projekteve ose programeve të tyre të vazdueshme dhe të pranuara që pritet të realizohen.

Plani i përbashkët i punës për vitin 2023 u zhvillua në procesin pjesëmarrës. Ndryshimi i kontekstit zhvillimor dhe prioriteteve strategjike u diskutuan në punëtoritë që u zhvilluan në fund të nëntorit dhe në fillim të dhjetorit të vitit 2022 me mbi 120 përfaqësues nga qeveria, donatorët dhe shoqëria civile, ndërsa drafti i Planit të përbashkët të punës u nda me mbi 300 përfaqësues të subjekteve partnere. Reagimet e marra përfshihen në PPP në masën e realizueshme. Sidoqoftë, Plani i përbashkët i punës është një dokument i gjallë që përditësohet rregullisht gjatë gjithë vitit, i bazuar në kontekstin që ndryshon, kërkesën e pranuar

dhe mjetet në dispozicion. Çdo nevojë e mëtejshme për ndryshime dhe përshtatje do të merret drejtpërdrejtë nga njësítë përkatëse të OKB-së.

### Kërkesat për financim për vitin 2023

Buxheti i përgjithshëm i vlerësuar për të gjitha aktivitetet është 45.2 milion dollarë, nga të cilat 27.7 milion dollarë (61.2%) janë tashmë të siguruara dhe 17.5 milion dollarë (38.8%) ende duhet të mobilizohen. Ky është buxheti fillestar i vlerësuar, që do të ndryshojë pak, pasiqë të mbyllen llogaritë e vitit dhe buxhetet e pashpenzuara të transferohen në planet e punës të vitit 2023. Shumat e përgjithshme do të rregullohen gjatë gjithë vitit dhe me shqyrtimin e përparimit të mesit të vitit.



### Rishikimi dhe monitorimi i PPP-ve

KBZHQ dhe PPP janë digitalizuar përmes [INFO të OKB-së](#), që është platforma online e planifikimit, monitorimit dhe raportimit. Raporti pasqyron përpjekjet e sistemit të zhvillimit të OKB-së për të përmirësuar koherencën, transparencën dhe llogaridhëni dhe për të adresuar më mirë nevojat dhe priorititetet e shteteve anëtare të OKB-së.

Mjeti inkurajon monitorimin më të rregullt të planeve të përbashkëta të punës në mënyrë që të gjitha aktivitetet e zhvillimit tëjenë në rrugën e duhur për të dhënë rezultate. Kjo i mundëson liderësit të lartë të bëjë korrigjime në programim ose të zhvendosë resurset në kohë reale. Publiku gjithashtu mund të shohë një pamje të plotë të aktiviteteve të sistemit të zhvillimit të OKB-së përmes tabelave publike të lidhura me faqet e internetit të UNCT-së.

## REZULTATI 1: PROSPERITETI GJITHËPËRFSHIRËS

Rezultati përkatës:	Deri në vitin 2025, standardi jetësor i të gjithë njerëzve në Maqedoninë e Veriut përmirësohet përmes qasjes së barabartë në punë të denjë dhe punësim prodaktiv të gjeneruar nga një ekosistem i biznesit gjithëpërfshirës dhe inovativ
Subjekti kryesues i Kombeve të Bashkuara:	ILO
Rezultatet e anëtarëve të grupit:	FAO, ILO, UNDP, UN Women, IOM, UNHCR, UNESCO, ITU
Partnerët nacional:	Ministria e punës dhe politikës sociale; Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave; Ministria e arsimit dhe shkencës, Agjencia e Punësimit; Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik; sindikatat; dhomat e tregtisë; këshillat ekonomikë dhe socialë; organizatat e punëdhënësve; shoqatat e fermerëve, organizatat e prodhuesve
Kohëzgjatja e planit të punës:	1 vit
Datat e parashikuara të fillimit/mbarimit:	1 janar 2023 – 31 dhjetor 2023

### PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË VITIT 2023

*(për aktivitetet e detajuara të subjekteve të OKB-së sipas këtij rezultati, ju lutemi rishikoni skedarin të bashkëngjitur në excel)*

Gjatë vitit 2023, Kombet e Bashkuara do të vazhdojnë me ndërhyrjet që mbështesin standardin e jetesës së njerëzve, duke rritur qasjen në punësim cilësor dhe produktiv dhe mjeshterës që mbështet inovacionin dhe përfshirjen.

Në këtë kontekst, OKB-ja do të mbështesë krijimin e vendeve të punës në ndërmarrjet e qëndrueshme dhe moderne, kryesisht NVM-të, që janë konkurruese dhe rezistente ndërkombëtarisht dhe mbështesin ekonominë qarkulluese në sektorët kryesorë të ekonomisë, duke përfshirë sektorët krijuar dhe të kulturës. Për të avancuar këtë, Kombet e Bashkuara gjithashtu do të punojnë në rritjen e punësimit të grupeve të rrezykuara, siç janë të rinjtë, personat për të cilat ka vështirësi përfshirjen e punësim dhe persona me aftësi të kufizuara duke krijuar grupin e duhur të aftësive, shërbimeve mbështetëse dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Kombet e Bashkuara gjithashtu do të punojnë në rritjen e një mjeshterës që mbështesin standardin e jetesës së njerëzve, duke rritur qasjen në punësim cilësor dhe produktiv dhe mjeshterës që mbështetin sektorët kryesorë të ekonomisë, duke përfshirë sektorët krijuar dhe të kulturës. Për të avancuar këtë, Kombet e Bashkuara gjithashtu do të punojnë në rritjen e punësimit të grupeve të rrezykuara, siç janë të rinjtë, personat për të cilat ka vështirësi përfshirjen e punësim dhe persona me aftësi të kufizuara duke krijuar grupin e duhur të aftësive, shërbimeve mbështetëse dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Për të mbështetur një ekonomi rurale konkurruese dhe gjithëpërfshirëse, OKB-ja do të vazhdojë të punojë në integrimin e aspektit gjinor në politikat përkatëse dhe do të mbështesë institucionet përfshirjen e sektorëve konsolidimin dhe lëvizshmërinë e tokës dhe përfshirjen e menaxhimin e shëndetit të kafshëve.

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar (në USD):*	\$ 6,356,280
* Buxheti i përgjithshëm i parashikuar përfshin si shpenzimet direkte të programit ashtu edhe shpenzimet indirekte të mbështetjes.	
<b>Nga të cilat:</b> me financim	\$ 5,551,279
Pa financim	\$ 805,001
Buxheti i vlerësuar përfshirjet (në USD)	
Sipas autputit:	Autputi 1.1. \$ 947,219
	Autputi 1.2. \$ 2,523,634

	Autput 1.3	\$ 1,855,427
	Autputi 1.4	\$ 340,000
	Autputi 1.5	\$ 690,000

## REZULTATI 2: SHËRBIME CILËSORE PËR TË GJITHË

Rezultati përkatës:	Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut kanë qasje universale në shërbimet sociale cilësore të bazuara në të drejtë – kujdes shëndetësor, arsim dhe mbrojtje e nevojshme sociale dhe për fëmijët - të rrënjosura në sisteme rezistente ndaj emergjencave.
Subjekti kryesues i Kombeve të Bashkuara:	UNFPA
Rezultatet e anëtarëve të grupit:	IOM, UNFPA, UNHCR, UNICEF, UN Women, WHO
Partnerët nacional:	Ministria e shëndetësisë; Ministria e arsimit; Ministria e punës dhe politikës sociale; institutet shëndetësore, shoqatat ose Drejtoretë; institutet për trajnim profesional; sindikata e të punësuarve shëndetësorë; shoqëria Civile; akademia, sektori privat
Kohëzgjatja e planit të punës:	1 vit
Datat e parashikuara të fillimit/mbarimit:	1 janar 2023 – 31 dhjetor 2023

### PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË VITIT 2023

**(për aktivitetet e detajuara të subjekteve të OKB-së sipas këtij rezultati, ju lutemi rishikoni skedarin të bashkëngjitur në excel)**

Mbrojtja më e mirë dhe ofrimi efikas i shërbimeve sociale për të gjithë personat që jetojnë në vend, por veçanërisht për ata që kanë mbetur pas, nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme se këto vite. Ajo që filloj me pandeminë e Kovid-19 dhe vazhdoi me krizat e energjisë dhe ushqimit gjatë gjithë vitit 2022, ndikon në mënyrë disproporcionale te personat më të rezikuar.

Me qetësimin e pandemisë me Kovid-19, reformat e sistemit të **kujdesit shëndetësor** parësor tanë mund të vazhdojnë me shpejtësi të plotë. Në vitin 2023, subjektet e OKB-së do të ofrojnë mbështetje teknike dhe këshilluese për Ministrinë e shëndetësisë për krijimin e njësisë së analizës së politikave, zhvillimin e një plani/strategjje koncize për adresimin e sfidave kryesore të sistemit shëndetësor dhe zhvillimin e një plani strategjik të komunikimit. Më shumë aktivitete do të përfshijnë Iniciativën e hipertensionit në një vend të demonstrimit; zhvillimin e Master planit për kujdesin shëndetësor parësor; vazhdimesinë e planeve të ristrukturimit të KSHP; trajnimet e profesionistëve të kujdesit shëndetësor parësor; hartimin dhe shpërndarjen e mjeteve digitale; zhvillimin e planit kombëtar të sigurisë së pacientit dhe planit të veprimit për forcimin e Agjencisë për akreditimin dhe cilësinë e institucioneve shëndetësore. Aktivitetet e iniciuara në vitin 2022 në lidhje me përforcimin e shëndetit mendor në KPSH do të vazhdojnë me hartezimin e shërbimeve të shëndetit mendor; dialogun për politika; aktivitetet për ngritjen e vetëdijes; zhvillimi i planit kombëtar për përforcimin e shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe promovimin e gjetjeve të studimit të HBSC pët vitin 2022.

Shëndeti i nënës dhe i të porsalindurit do të përmirësohet më tej përmes mbështetjes së vazhdueshme teknike për realizimin e anketave për vdekjen perinatale dhe për zbatimin e master planit për kujdesin perinatal; Inicimi i aktiviteteve për digitalizimin e mbledhjes së të dhënave për rishikimet e vdekjes perinatale; Mbështetja teknike në futjen e rastevës kritike (rastet afér humbjes të nënave – OSRS – OSRS). Do të mbështetet qasja e përmirësuar në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues për ata që më së shumti kanë mbetur prapa në zonat e largëta përmes ofrimit të shërbimeve të lëvizshme gjinekologjike, këshillimet për planifikimin familjar, shëndetin e nënës, parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe diagnostifikime të tjera shëndetësore themelore, si dhe duke përfshirë përforcimin e përfaqësimit dhe komunikimit me publikun e gjërë për mjetet dhe burimet në dispozicion për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.

Do të vazhdojë ndërtimi i kapaciteteve për përmirësimin e mbikëqyrjes, mbulimit dhe menaxhimit të vaksinave duke përfshirë edhe ato për kovid. Përforcimi i mbikëqyrjes dhe monitorimit të SJT, si dhe përforcimi i kapaciteteve kombëtare për prezantimin e shkollave që promovojnë shëndetin.

OKB-ja do të vazhdojë të mbështesë reformën e **arsimit**, rishikimin e politikave të arsimit dhe programet shoqëruese të favorshme për mqedise të sigurta, të shëndetshme, të përgjegjshme ndaj gjinisë, gjithëpërfshirëse dhe me burime të përshtatshme duke mbështetur zhvillimin e kurrikulave të arsimit fillor dhe të mesém. Ajo do të ofrojë mbështetje në zhvillimin dhe zbatimin e ngritjes së kapaciteteve gjithëpërfshirëse dhe cilësore të profesionistëve në shërbim dhe para shërbimit; dhe do të mbështesë hartimin dhe zbatimin e komunikimit të bazuar në dëshmi për iniciativat e zhvillimit në fushën e arsimit dhe mbrojtjes së fëmijëve (duke përfshirë FAK dhe pakicat), si dhe krijimin e mjeteve dhe burimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse të të mësuarit (gjithashtu për të adresuar Kovid-19), duke përfshirë burimet digitale, që janë në përputhje me kurrikulat e arsimit parashkollar, fillor dhe të mesém. Mbështetja për optimizimin e shkollave fillore dhe përmirësimin e sistemit të alokimeve buxhetore në arsimin fillor dhe të mesém do të përforcohet në vitin 2023. Përpjekjet do të vazhdojnë për të siguruar që fëmijët e lënë pas, duke përfshirë fëmijët e refugjatëve dhe azilkërkuesve janë të përfshirë në procesin arsimor.

Mbështetja për zbatimin e reformës së mbrojtjes sociale do të vazhdojë me aktivitete në disa fusha. Integrimi i qëndrimit të përkohshëm të refugjatëve, emigrantëve dhe azilkërkuesve do të mbështetet përmes ngritjes së kapaciteteve për ofrimin e përmirësuar të shërbimeve sociale, konsultimeve dhe asistencës; përmirësimit të procedurave kombëtare të referimit për individët në rrezik; ofrimit të mbështetjes ligjore për personat në fjalë, ose ofrimit të mbështetjes së përshtatjen e legjislacionit të nevojshëm.

Mbrojtja e fëmijëve mbetet fusha e dytë e madhe e veprimtarisë së mbrojtjes sociale të subjekteve të OKB-së. Aktivitetet për hartimin dhe vendosjen e shërbimeve që mbështesin prindërit dhe kujdestarët për të nxitur zhvillimin e fëmijëve dhe kujdesin dhe për të parandaluar fatkeqësitë të jenë të arritshme për të gjitha familjet dhe kujdestarët dhe do të vazhdojnë këtë vit si dhe mbështetja drejtë zbatimit të plotë të modelit të vlerësimit për mbështetje shtesë arsimore, shëndetësore dhe mbrojtje sociale për fëmijët dhe të rinjtë, në bazë të Klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit (KNF). Zbatimi i rekomandimeve nga varfëria shumë-dimensionale do të intensifikohet së bashku me përfaqësimin për përmirësimin e politikave, duke përfshirë përmirësimin e sistemit statistikor kombëtar. Vlerësimet mbi ndërhyrjet e UNICEF-it për përfshirjen e fëmijëve me aftesi të kufizuara dhe mbështetjen e reformës sociale do të përfundojnë për të siguruar udhëzime të vlefshme mësimore për programimin e mëtejshëm.

Parandalimi dhe lufta kundër të gjitha formave të dhunës është fusha e fundit e punës së OKB-së nën këtë rezultat. Hulumtimi i dëmeve do të kryhet në rajon për të kuptuar shfrytëzimin dhe eksplotimin seksual të fëmijëve në internet dhe për të krijuar një dëshmi që ndihmon qeveritë të përforcojnë parandalimin, përgjigjen dhe përditësimin e legjislacionit. Aktivitetet për DHBGJ dhe dhunën në familje do të përshpejtohen – zhvillimi i programit për kryerësit, hartëzimi i shërbimeve të DHMGJ dhe SHSR dhe identifikimi i hendeqeve, ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve; zhvillimi i legjislacionit, mbështetja e viktimave, drejtpërdrejtë ose përmes mbështetjes së OSCH-ve, si dhe zhvillimi i një sistemi të ri të integruar të mbledhjes së të dhënavë.

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar (në USD):*		\$ 4,210,846
* <i>Buxheti i përgjithshëm i parashikuar përfshin si shpenzimet direkte të programit ashtu edhe shpenzimet indirekte të mbështetjes.</i>		
Nga të cilat: me financim		\$ 3,134,593
pa financim		\$ 1,076,253
Buxheti i vlerësuar për autputet (në USD)		
Sipas autputit:	Autput 2.1	\$ 1,075,700
	Autputi 2.2	\$ 1,155,550
	Autputi 2.3	\$ 1,385,891
	Autputi 2.4	\$ 593,705

### REZULTATI 3: MJEDIS JETËSOR I SHËNDETSHËM

Rezultati përkatës:	Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga veprimet ambicioze klimatike, burimet natyrore të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti i ruajtur mirë përmes rregullimit të mirë të mjedisit jetësor dhe komuniteteve rezistente ndaj fatkeqësive
Subjekti kryesues i Kombeve të Bashkuara:	UNDP
Rezultatet e anëtarëve të grupit:	FAO, UNDP, UNEP, UNECE, UNOPS, UNESCO, UNICEF, UNIDO, WHO, IOM, ITU, UNITAR
Partnerët nacional:	ZKM për çështjet ekonomike, Ministritë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor, bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, arsimit dhe shkencës, shëndetësisë, ekonomisë, financave dhe kulturës. Partnerë të tjerë përfshijnë Shërbimin kombëtar hidrometeorologjik, Agjencinë kombëtare të zgjerimit, Qendrën për menaxhim të krizave, agjencitë e mbrojtjes civile, Institutin për shëndetin publik, Agjencinë e ushqimit dhe veterinarisë, Qytetin e Shkupit, komunat në rajonet e Shkupit dhe Pollogut, komunat rreth liqeneve të Ohrit dhe Prespës, dhe Radovishin, organizatat e shoqërisë civile, institucionet akademike, shkollat, bankat komerciale dhe organizatat ndërkombëtare/IFN.
Kohëzgjatja e planit të punës:	1 vit
Datat e parashikuara të fillimit/mbarimit:	1 janar 2023 – 31 dhjetor 2023

#### PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË VITIT 2023

(për aktivitetet e detajuara të subjekteve të OKB-së sipas këtij rezultati, ju lutemi rishikoni skedarin të bashkëngjitur në excel)

Në periudhën e viteve 2021-2025, kontributi i subjekteve të OKB-së për mjedisin e shëndetshëm jetësor përqendrohet në mbështetjen e politikave, ndërtimin e kapaciteteve dhe veprimet e komunitetit për zhvillimin e emetimeve të ulëta dhe rezistencën shumë-sektoriale ndaj ndryshimeve klimatike; menaxhimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të burimeve natyrore; parandalimin dhe përgjigjen ndaj kërcënimeve të ndotjes së ajrit; reduktimin dhe përgjigjen efektive të rezikut nga fatkeqësitet; dhe reduktimin e mbetjeve dhe menaxhimin efikas të mbeturinave.

Për ndryshimin klimatik (Autputi 3.1), në vitin 2023 OKB planifikon të mbështesë vendin në zhvillimin dhe monitorimin e politikave (mbështetje për rritjen e Kontributit të përcaktuar kombëtar (KPK), përmes koordinimit më të mirë të aktorëve kryesorë kombëtarë dhe zhvillimit të propozimeve konkrete të projektit dhe mobilizimit të burimeve për të njëjtën gjë; zhvillimi i Planit kombëtar të përshtatjes dhe aspektet shoqëruese institucionale, të planifikimit dhe programimit<sup>2</sup>, zhvillimi i Planeve kombëtare për heqjen graduale të HCFC dhe zvogëlimin gradual të HFC), në qasjen në financa (kreditë e favorshme për NVM-të dhe familjet për energji të ripërtëritshme dhe efikasitet të energjisë përmes Fondit të financimit të gjelbër, qasja në Fondin e gjelbër të klimës dhe financimin inicial (seed) të kompanive për të rintjtë për modelimin e zgjidhjeve inovative miqësore ndaj klimës), dhe rezistenca shumë-sektoriale ndaj ndryshimeve klimatike (ndryshimi klimatik dhe bujqësia: përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe menaxhimi efikas i tokës dhe burimeve ujore, zhvillimi i të dhënave me cilësi të lartë për vendimarrje në kontekstin e bujqësise dhe agroekologjisë së zgjuar klimatike, rritja e sistemeve iniciale rezistente dhe promovimi i inicimeve cilësore të varieteteve tolerante ndaj klimës dhe ndryshimeve klimatike dhe arsimit: integrimi i ndryshimeve klimatike në politikat kombëtare të arsimit dhe kurrikulave).

Në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të burimeve natyrore (Autputi 3.2) në vitin 2023 OKB-ja do të ofrojë mbështetje për një sërë aktivitetesh të ndryshme që lidhen me tokën dhe pyjet (masa të ndryshme të përqendruara në neutralitetin e degradimit të tokës, menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe pyjeve dhe menaxhimin e qëndrueshëm të peizazheve malore duke përfshirë zhvillimin e Strategjisë për mbrojtjen e tokës, Ligjin për mbrojtjen e tokës dhe Udhëzimet për hartimin e programit të monitorimit të cilësisë së tokës, përforcimin e kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, peizazheve malore dhe tokës, ruajtjen e biodiversitetit në sektorin e bujqësisë dhe zbatimin praktik të qasjes së integruar të peizazhit në zonën pilot në Malet e Sharrit), ujë (raioni i liqenit të Prespës: mbështetje e re për përmirësimin e mbrojtjes së natyrës përmes përmirësimit të infrastrukturës së mbetjeve dhe ujërave të ndotura dhe gjelbërimit të bujqësisë lokale, turizmit dhe aktiviteteve të tjera

<sup>2</sup>Ky aktivitet është në zhvillim e sipër dhe nuk janë siguruar ende mjete

të sektorit privat, përforcimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe liqeni i Ohrit: zhvillimi i studimit të fizibilitetit për planin urban të zonës bregdetare të liqenit të Ohrit).

Në vitin 2023, do të zgjerohet mbështetja e OKB-së për zvogëlimin e ndotjes së ajrit (Autputi 3.3.), me ndihmë gjithëpërfshirëse teknike dhe këshilluese në 8 qytete anembanë vendit që përballen me probleme të konsiderueshme të ndotjes së ajrit - Shkup, Manastir, Tetovë, Gostivar, Kumanovë, Kavadar, Strumicë dhe Strugë. Masat do të përqendrohen në sigurimin e ngrohjes më të pastër të ndërtesave publike, transportit, industrisë, bujqësisë dhe menaxhimit të mbetjeve, si dhe ngritjen e vetëdijes publike dhe përforcimin e monitorimit të ndotjes së ajrit. Edukimi i synuar, vetëdijësimi dhe aktivitetet e mobilizimit për ndotjen e ajrit janë planifikuar gjithashtu me fëmijët. Më tej, do të analizohen ndërlidhjet midis lëvizshmërisë të njerëzve dhe ndotjes së ajrit.

**Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë (Autputi 3.4):** Mbështetja e OKB-së për zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet në rajonin e Pollogut dhe në pellgun e lumit Drin do të vazhdojë në vitin 2023. Aktivitetet e planifikuara përfshijnë restaurimin e shtratit të lumit, stabilizimin e rrëshqitjeve prioritare të tokës, krijimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe njohurive dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit publik në Pollog dhe zhvillimin e modelit hidrologjik dhe hidraulik për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, programin gjithëpërfshirës të ndërtimit të kapaciteteve, restaurimin e lumit Sateska dhe zbatimin e masave jo-strukturore në pellgun e lumit Drin. Gjithashtu, aktivitetet për një gatishmëri më të madhe të emergjencave shëndetësore përmes aktiviteteve të ndryshme, siç është zhvillimi i studimit të fizibilitetit për MSH për hartimin e Analizës e rrezikut dhe rrezikueshmërisë dhe hartëzimit (ARRRH/STAR); Zhvillimi dhe kostingu i Planit strategjik kombëtar të veprimit për sigurinë shëndetësore (PKVSSH); ndërtimi i kapaciteteve të laboratorëve kombëtarë dhe aktivitetet e komunikimit të rrezikut. Më tej, është planifikuar ngritja e kapaciteteve për zhvendosjen e njerëzve për shkak të fatkeqësive dhe zbatimi i Indeksit informativ nën-kombëtar për Menaxhimin e Riskut.

**Mbetjet (Autputi 3.5):** Në vitin 2023, OKB-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të konsiderueshme në pastrimin e mbetjeve të rrezikshme në pikat e nxehta të mjedisit jetësor (kompleksi i fabrikës OHIS: mbeturinat HCH, pellgu i vogël i mbetjeve), përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta në rajonin e liqenit të Prespës dhe në qendrat e pritjes së përkohshme të migrantëve në Kumanovë dhe Gjevgjeli, si dhe monitorimin e e-mbetjeve.

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar (në USD):*		\$ 23,426,526
* Buxheti i përgjithshëm i parashikuar përfshin si shpenzimet direkte të programit ashtu edhe shpenzimet indirekte të mbështetjes.		
<b>Nga të cilat:</b> të financuara		\$ 8,213,501
Pa financuara		\$ 15,213,025
Buxheti i vlerësuar për autputet (në USD)		
Sipas autputit:	Autput 3.1.	\$ 6,820,248
	Autputi 3.2.	\$ 6,567,478
	Autputi 3.3.	\$ 4,371,658
	Autputi 3.4.	\$ 3,007,842
	Autputi 3.5.	\$ 2,659,300

#### REZULTATI 4: QEVERISJA E MIRË

Rezultati përkatës:	Deri në vitin 2025, njerëzit në Maqedoninë e Veriut përfitojnë nga përmirësimi i sundimit të ligjit; politika të bazuara në dëshmi, parashikuese dhe me përgjegjësi gjinore; kohezion më i madh social; dhe ofrim efektiv të shërbimeve nga institucionet transparente, llogaridhënëse dhe të përgjegjshme
Subjekti kryesues i Kombeve të Bashkuara:	UNHCR
Rezultatet e anëtarëve të grupit:	UNDP, UN Women, UNHCR, IOM, UNODC, UNICEF, UNFPA, OHCHR, UNOPS, UNESCO
Partnerët nacional:	Kabineti i Kryeministrat, MPB, MPMS, MPJ, MSH, Ministria e kulturës, Ministria e arsimit dhe shkencës, Ministria e vetëqeverisjes lokale, Ministria e financave, Byroja për zhvillim rajonal, Enti shtetëror i revizionit, Drejtoria e të hyrave publike, Agjensioni për rini dhe sport, Banka kombëtare, OSSH, Akademia e gjykatësve de prokurorëve, Avokati i popullit, Trupi kombëtar i koordinimit të mosdiskriminimit, IKD, MPJ – Mekanizmi kombëtar për raportim dhe ndjekje, OPD, Grupi ndërministror i punës për miratimin e politikave të migracionit, Parlamenti, Dhoma e avokatëve, MYLA, MD, SA, Gjyqësori, MPB, Prokuroria publike republikane, Prokuroria për krimin e organizuar dhe korruptionin, Drejtoria e doganave, WCO, INTERPOL, Agjencia e doganave; Komisioni kombëtar për UNESCO-n, Shoqata e punëtorëve financiar (SHPF), Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale, Rrjeti i shoqatave të institucioneve lokale të Evropës juglindore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, Këshilli kombëtar për barazinë gjinore, Akcija Zdruzenska, OSHC-të e tjera dhe Akademia
Kohëzgjatja e planit të punës:	1 vit
Datat e parashikuara të fillimit/mbarimit:	1 janar 2023 – 31 dhjetor 2023

#### PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË VITIT 2023

(për aktivitetet e detajuara të subjekteve të OKB-së sipas këtij rezultati, ju lutemi rishikoni skedarin të bashkëngjitur në excel)

OKB-ja në Maqedoninë e Veriut punon drejt institucioneve efektive, të përgjegjishme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes, dhe promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut për të gjithë, duke u fokusuar në njerëzit e lënë pas ose në rrezik për t'u lënë pas, duke përfshirë gratë, fëmijët, të rinjtë që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim (NEET), personat me aftësi të kufizuara, romët dhe komunitetet e tjera etnike, refugjatët, azilkërkuesit, emigrantët, personat e zhvendosur brenda vendit (PZHV) dhe personat pa shtetësi, personat LGBTI, personat në zonat rurale dhe personat e moshuar.

Gjatë vitit 2023, OKB-ja do të vazhdojë të përforcojë partneritetin dhe kapacitetet e qeverisë dhe të gjithë aktorëve të tjerë për të përshpejtuar progresin në reformat politike, legjislative dhe institucionale që avancojnë qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit. Qasja e gjithë qeverisë dhe e gjithë shoqërisë, do të vazhdojë të jetë e gdhendur në proceset kryesore strategjike kombëtare – Strategjia kombëtare për zhvillim që përcakton trajktoren e zhvillimit për 20 vitet e ardhshme, negociatat e pranimit në BE dhe arritjen e OZHQ-ve.

OKB-ja do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e politikave dhe ligjeve në përputhje me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe *acquis tē BE*. Fushat kryesore përfshijnë të drejtat themelore, mosdiskriminimin, barazinë gjinore, menaxhimin e migracionit, sektorin e drejtësisë dhe drejtësinë përfshirët, kthimin e pasurisë dhe luftën kundër korruptionit dhe kimeve të organizuara transnacionale (siç janë trafikimi i personave, kontrabanda e emigrantëve, financimi i paligjshëm i terrorizmit, armët e zjarrit dhe krimet seksuale digitale).

Kapacitetet zbatuese të pushtetit qendror dhe lokal, gjyqësorit, institucioneve përgjegjëse përfshirët zbatimin e ligjit dhe institucioneve të tjera të pavarura do të rriten përfshirët siguruar hartimin e politikave të ardhshme, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në dëshmi, të mbështetura me alokime të mjaftueshme buxhetore përfshirët funksionuar në mënyrë efektive. Kapacitetet kombëtare përfshirët anëtarësim në BE do të forcohen më tej, veçanërisht në procesin e përafrimit (NPPA), transponimin e *acquis tē* barazisë gjinore dhe aftësitë negociuese të Parlamentit dhe Qeverisë.

OKB-ja do të vazhdojë të investojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënieve së shpenzimeve publike që janë thelbësore përfshirët qeverisjen e mirë. Analiza e shpenzimeve publike dhe monitorimi i drejtësisë përfshirët fëmijët dhe arsimin fillor dhe të mesëm do të përmirësohet. Mbikëqyrja publike e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe makineria e re gjinore do të përforcohet, së bashku me masat sistematike përfshirët transparencën fiskale dhe

Ilogaridhënien e pushtetit qendor dhe lokal. Shërbimet do të bëhen më të përgjegjshme ndaj nevojave të grupeve të përjashtuara dhe rezikueshmëritë e tyre sociale dhe ekonomike, duke përmirësuar cilësinë e jetesës së tyre. Zgjidhjet inovative dhe digitale, bashkëpunimi më i fortë ndërsektorial dhe ndërinstitucional, grantet e komunitetit për OSHC-të në nivel lokal dhe iniciativat për të rinxjtë dhe gratë, dhe tregues të qartë për të matur dhe demonstruar progresin, do të synojnë rivendosjen e besimit të publikut në sistemin e qeverisjes.

Kohezioni shoqëror dhe respekti për diversitetin do të promovohen përmes veprimeve të përforcuara reciprokisht, duke përfshirë mbështetjen për këshillat rimore komunale, platformat e dialogut ronor me politikëbërësit; parandalimin e ndarjeve, gjuhës së urrejtjes dhe maskuliniteve dhe stereotipeve gjinore midis të rinjve me identitetet dhe prejardhje të ndryshme. Do të promovohet ndërveprimi dhe bashkëpunimi midis mediave publike dhe rrjeteve të mediave rimore lokale dhe ndikimeve nga të rinxjtë. OKB-ja do të punojë dhe trajnojë gazetarët, dhe do të mbështesë ngjarjet publike dhe përbajtjet mediatike që do të frymëzojnë ndryshime shoqërore dhe tregime pozitive për grupet e rezikuara dhe personat që rrezikojnë të mbeten prapa, integrimin e tyre dhe kontributin në shoqëri.

Do të vazhdojë të promovohet pjesëmarrja kuptimplotë e shoqërisë civile, komuniteteve të ndryshme, grupeve të përjashtuara dhe njerëzve të lënë pas, si dhe partnerëve jo-tradicional në vendimmarje. Përfshirja dhe angazhimi i të rinjve, adoleshentëve, grave, personave me aftësi të kufizuara, njerëzve të padukshëm dhe të tjerëve që jetojnë në margjina të shoqërisë do të inkurajohen sistematikisht. Njerëzit e lënë më larg pas do të fuqizohen për të kërkuar mbrojtje, drejtësi dhe ndihmë juridike pa pagesë, veçanërisht ato në kontekst humanitar. Zhdukja e pashtetësisë dhe krijimi i rrugëve plotësuese për integrimin e refugjatëve, emigrantëve dhe grupeve të tjera janë pjesë integrale e përpjekjeve për një zhvillim më të qëndrueshëm, të drejtë dhe të barabartë.

Buxheti i përgjithshëm i parashikuar (në USD):*		\$ 11,227,565
<b>* Buxheti i përgjithshëm i parashikuar përfshin si shpenzimet direkte të programit ashtu edhe shpenzimet indirekte të mbështetjes.</b>		
Nga të cilat: me financim		\$ 10,816,632
Pa financim		\$ 410,933

Buxheti i vlerësuar për autputet (në USD)

Sipas autputit:	Autputi 4.1.	\$ 4,328,748
	Autputi 4.2.	\$ 3,898,828
	Autputi 4.3.	\$ 1,681,153
	Autputi 4.4.	\$ 1,078,836
	Autputi 4.5.	240,000 \$